



eptisa

PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB



WORLD BANK GROUP

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i Kontratës: CS02

Shërbime Konsulence

për

Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore

Progres Raporti i Ndërmjetëm


Nr. 5

Komponenti 3

D-3.5

Versioni Paraprak

Prill 2021



TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PROJEKTIT

Emri i Projektit:	Shërbim Konsulencë Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore - Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate .(RRMSP)
Numri i Referencës së Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
Vendi:	Shqipëri
Konsulenti:	JV NTU InternationalA/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
Adresa:	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Denmark
Telefoni:	+45 99 30 0000
Faks:	+45 99 30 0001
PersonKontakti:	Dritan Dibra – Menaxher Projekti, Eptisa
E-mail:	ddibra@eptisa.com
DataeRaportit:	Prill 2021
Autorët e raportit:	Antonino Tripodi, K-6 Specialist Ndërkombëtar për të Dhënat e Aksidenteve Florin-Marius Dumitru, K-7 IT Specialist i Manaxhimit të Projekteve Blerina Kurti, NK-5 Specialiste Lokale për të Dhënat e Aksidenteve Renato Kurti, NK-6 IT Specialist Lokal i Manaxhimit të Projekteve Arben Myrtaj, NK-7 Specialist të Dhënash <i>Me kontribut të:</i> <i>Stelios Efstathiadis, K-1 Specialist në Menaxhimin e Sigurisë Rrugore–Drejtuës i Ekipit të Ekspertëve</i>

SQARIM

Ky raport (duke përfshirë çdo shtojcë dhe dokument të bashkëlidhur) është përgatitur për përdorim ekskluziv dhe perfitim të Qeverisë Shqiptare/ Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bankës Botërore, dhe vetëm për qëllimin për të cilin është përgatitur. Asnjë pjesë e këtij raporti nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet apo t'i komunikohet një palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të JVNTU/EPTISA. JVNTU/ EPTISA nuk pranon asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për qëllim tjetër nga ai për të cilin është menduar, as nga palë të treta.

KONTROLLI I DOKUMENTIT

Numri i Referencës së Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbim Konsulencë Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore- Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)
Vendi	Shqipëri
Data	30.04.2021
Versioni	N°01

Versioni	Data	Pergatitur nga	Rishikuar nga
N°01	30.04.2021	Antonino Tripodi	Dragan Kostadinov Drejtor Projekti

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument përbën Raportin e 5-të të Përkohshëm të Progresit të **Komponentit 3** të Asistencës Teknike të Sigurisë Rrugore nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP), në lidhje me **asistencën teknike në infrastrukturën e sigurt rrugore**.

Raporti mbulon aktivitetet që kanë të bëjnë me Sistemin e Analizës së të Dhënave dhe të Dhënave të Aksidenteve Rrugore për Tremujorin nga Shkurt 2021 deri në Prill 2021. Qëllimet e këtij komponenti janë:

- 1. Mbështetje për i vlerësimin dhe përditsimin e sistemit (kombëtar) të aksidenteve rrugore dhe sistemit të analizës së të dhënave.*
- 2. Trajnim për përdoruesit e sistemit në teknikat diagnostikuese dhe aplikimet e sistemit.*
- 3. Mbështetje për përgatitjen e një programi (kombëtar) të përditësimit të sistemit pas-projektit.*

Aktivitetet e Komponentit 3 të realizuara gjatë tremujorit nga Shkurt 2021 deri në Prill 2021, u kryen nën peshën e Forcave Madhore për shkak të krizës pandemike Covid-19 dhe u përqendruan në:

- Zbatimi i një programi trajnimi mbi Sistemin dhe Analizën e të Dhënave të Aksidenteve të Trafikut Rrugor.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i programit të trajnimit.

PERMBAJTJA

1. Hyrje	8
1.1 Objektivat dhe rezultatet e aktiviteteve të kryera deri më tani.....	8
2. Progresi: Shkurt 2021 – Prill 2021	12
2.1 Hyrje.....	12
2.2 Aktivitetet e realizuara	12
2.2.1 Mbështetje për përgatitjen e specifikimeve dhe prokurimin e një baze të re të dhënash /sistemi informacioni	12
3. Periudha pasardhese	12
3.1 Plani i Punës.....	12
3.2 Pasqyra e aktiviteteve.....	13

Shtojca 1 - Raporti i Zbatimit të Ngritjes së Kapaciteteve dhe Trajnimeve

Shtojca 2 - Raporti i Vlerësimit të Ngritjes së Kapacitetit të Palëve të Interesit

1. Hyrje

Projekti konsiston në katër rezultate kryesore nën RRMSP, të cilat përfshijnë: (1) Forcimin e Departamentit të Sigurisë Rrugore (MIE) si zyrë udhëheqëse; (2) Ofrimi i asistencës teknike në infrastrukturën rrugore të sigurt; (3) Të vendosë sisteme të qëndrueshme të monitorimit dhe vlerësimit; dhe (4) Paraqitja dhe theksimi i sjelljeve të pasigurta në rrugët shqiptare përmes fushatave të ndërgjegjësimit: Për "Promovim" – Fushata Publicitare dhe Ndërgjegjësimi që Synojnë Sjelljet e Pasigurta.

Komponenti 3, të cilit i referohet ky raport, ka tre aktivitete kryesore, ku secili përfshin nën-aktivitete specifike që duhet të zbatohen. Tri aktivitetet kryesore janë si më poshtë:

- Mbështetje në vlerësimin dhe përditësimin e sistemit (kombëtar) të të dhënave dhe analizës së aksidenteve rrugore (Aktiviteti 3.1).
- Trajnim për përdoruesit e sistemit në teknikat diagnostikuese dhe aplikimet e sistemit (Aktiviteti 3.2).
- Mbështetje në përgatitjen e njëprogrami (kombëtar) të përditësimit të sistemit pas-projektit (Aktiviteti 3.3).

1.1 Objektivat dhe rezultatet e aktiviteteve të kryera deri më tani

Dy nga tre aktivitetet kanë filluar në tremujorin e dytë të projektit: Aktiviteti 3.1 dhe Aktiviteti 3.2. Aktiviteti i tretë është shtyrë për shkak të Force Majeure, pandemisë Covid-19, dhe do të fillojë më vonë.

Qëllimi i **Aktivitetit 3.1** është të rishikojë dhe përmirësojë aftësitë e sistemit për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave të Aksidenteve të Trafikut Rrugor (ATRR), të miratuara aktualisht në Shqipëri.

Rezultate të shumta priten për Aktivitetin 3.1:

- I. Përkufizimi i kërkesave të të dhënave për aksidentet e trafikut rrugor të të gjitha autoriteteve të identifikuara të angazhuara në përmirësimin e sigurisë rrugore.
- II. Vlerësimi i procedurave dhe sistemeve aktuale dhe të planifikuara për raportimin, regjistrimin dhe analizën e aksidenteve rrugore dhe shkallën në të cilën ato plotësojnë kërkesat e specifikuar të agjensisë.
- III. Rekomandime për përmirësime në procedurat aktuale dhe të planifikuara për raportimin, regjistrimin dhe analizën e aksidenteve rrugore.
- IV. Përgatitja e një plan koncepti për përmirësimin e sistemit, përfshirë kërkesat e rekomanduara të pajisjeve kompjuterike dhe softuerit me kosto paraprake si dhe të dokumentacionit të përdoruesit dhe nevojat e trajnimit të lidhura me to.
- V. Proçesi i rekomanduar për të koordinuar aktivitetet me komponentin e monitorimit dhe vlerësimit të projektit.
- VI. Hartimi i dokumenteve për prokurimin e shërbimeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit, në përputhje me praktikën më të mirë të proçedurave të tenderimit për zhvillimet komplekse të sistemit IT.
- VII. Mbështetje me përgatitjen e specifikimeve dhe prokurimin e një baze të re të të dhënave / sistemi të informacionit.

Deri më tani, të gjitha aktivitetet e Aktivitetit 3.1. janë kryer dhe kanë përfunduar.

Detyrat e hershme në bazë të këtij Aktiviteti u përqëndruan në identifikimin e nevojave kryesore të të gjithë aktorëve shqiptarë të përfshirë në mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave të Trafikut Rrugor. Janë kryer aktivitetet e mëposhtme:

- Identifikimi i palëve të interesuara të përfshira në mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave të aksidenteve.
- Takime me palët e interesuara për të vlerësuar procedurat aktuale dhe nevojat kryesore për zhvillimet e ardhshme.
- Përshkrimi i kërkesave dhe nevojave të palëve të interesuara për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave të aksidenteve.

Burimet kryesore të informacionit për aksidente rrugore në Shqipëri janë Policia Rrugore (për mbledhjen e të dhënave në terren) dhe Ministria e Shëndetësisë (për mbledhjen e informacionit për personat e lënduar). Për më tepër, aktorët e tjerë janë të përfshirë në procesin e sigurisë rrugore (Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Transporteve, Instituti i Statistikave).

Aktualisht, shumica e informacioneve dhe të dhënave për ATRR janë mbledhur dhe mirëmbajtur nga Policia Rrugore. Ata aktualisht përdorin një bazë të dhënash ndërtuar në MS Office Access, e cila përfshin përafërsisht tridhjetë fusha të futjes së të dhënave. Sidoqoftë, programit i mungon aftësia integrale GIS. Një formular raporti statistikor përdoret nga zyrtarët e policisë për të mbledhur informacione kur ndodh një aksident. Në përgjithësi, baza e të dhënave aktuale duket shumë e kufizuar në aftësinë e saj për t'u zgjeruar. Mungon gjithashtu aftësia për të komunikuar me bazat e tjera të të dhënave që ekzistojnë në Shqipëri. Policia gjithashtu i siguron Institutit të Statistikave të dhëna për aksidentet të cilat këta të fundit i përdorin në bazën e të dhënave të tyre interaktive në internet. Spitalet (veçanërisht qendra e traumave në Tiranë) janë të përfshirë në procesin e mbledhjes së të dhënave, por ato nuk sigurojnë direkt informacion për Policinë Rrugore.

Kërkesat dhe nevojat kryesore të palëve të interesuara të përfshira në procesin e ATRR lidhen me zhvillimin e një baze të dhënash / sistemi të ri informacioni qëlejon:

- Mbledhjen e të dhënave në terren (d.m.th. Aplikacion për pajisjet mobile).
- Analizë e thellë e sistemit të AksidentevetëTrafikutRrugor (ATRR).
- Menaxhim i besueshëm i të dhënave.
- Ndarja e të dhënave në kohë reale dhe automatike brenda zyrave të policisë rrugore dhe me aktorë të tjerë.
- Përfshirja e "të dhënave historike" në sistemin e ri.
- Përdorimi i të dhënave nga bazat e tjera ekzistuese të të dhënave.
- Disponueshmëria e aftësive GIS, si dhe analiza dhe raportime të thelluara.

Më pas, aktivitetet u përqëndruan në **vlerësimin e procedurave aktuale dhe të planifikuara për raportimin, regjistrimin dhe analizën e Aksidenteve të Trafikut Rrugor (ATRR)** dhe shkallën në të cilën ato plotësojnë kërkesat e specifikuar të agjensisë.

Për të vlerësuar sesi të përmirësohen procedurat aktuale të miratuara në Shqipëri, është bërë një krahasim me standardet e rekomanduara ndërkombëtare, si dhe me procedurat e miratuara në vendet e tjera (në Ballkan dhe në Evropë).

Standardet kryesore për mbledhjen e të dhënave të Aksidenteve të Trafikut Rrugor, të cilat duhet të përmbushë Shqipëria, duhet të jenë "Të dhënat e Komunitetit për aksidentet rrugore" (CARE) të Komisionit Evropian dhe rrjedhimisht, Seti i Përbashkët i të Dhënave të Aksidenteve "Common Accident Data

Set"(CADaS) që përbëhet nga një grup minimal të dhënash të standartizuara të elementeve të sigurisë rrugore.

Përmirësimet kryesore duhet të përqëndrohen në:

- Aksesueshmëria e të dhënave nga palët e interesuara përveç Policisë Rrugore.
- Pajtueshmëria me të dhënat e rekomanduara të CADaS (si në aspektin e variablave ashtue dhe të vlerave për secilën variabël).
- Mundësia e mbledhjes së disa prej variablave duke lidhur bazën e të dhënave për aksidentet me bazat e tjera ekzistuese të të dhënave për drejtuesit dhe automjetet.

Bazuar në vlerësimin, një grup **përmirësimesh të rekomanduara** është përgatitur për të përmirësuar procedurat aktuale dhe të planifikuara për raportimin, regjistrimin dhe analizën e aksidenteve rrugore.

Rekomandimet për zhvillimet e ardhshme fokusohen në:

- Elementet e të dhënave të Aksidenteve të Trafikut Rrugor: rekomandimi kryesor merret me ndryshimin e formularit aktual të mbledhjes së të dhënave për ta bërë atë në përputhje me standardet CADaS.
- Ndjekja e personave të lënduar: rekomandohet të ruhen procedurat aktuale të ndjekura nga Policia Rrugore dhe të futet standardi MAIS3 + për të bërë dallimin midis lëndimeve të lehta dhe të rënda.
- Ndaria e informacionit ndërmjet palëve të interesuara: është e rëndësishme për të përmirësuar shkëmbimin aktual të informacionit dhe të dhënave në mënyrë që të dhënat të jenë të arritshme me shpejtësi. Zhvillimi i sistemeve të reja të informacionit do të mbështesë këtë proces.
- Sistemi i ri i informacionit: rekomandohet të krijoni një system të ri informacioni për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave ATRR, duke zëvendësuar bazën e të dhënave aktuale të përdorur nga Policia Rrugore, e mbështetur nga pajisjet e nevojshme hardware.
- Hostimi i të dhënave kombëtare ATRR: baza e re e të dhënave kombëtare duhet të hostohet në Drejtorinë IT&C të Ministrisë së Brendshme, pasi bazat e tjera të rëndësishme të të dhënave të përdorura nga Policia Rrugore janë hostuar po atje.

Rekomandimet e dakorduara janë përkthyer më pas në një **plan koncept të detajuar për përmirësimin e sistemit aktual**.

Është propozuar edhe një arkitekturë e sistemit për Sistemin e Informacionit të Aksidenteve të Trafikut Rrugor. Plan-koncepti paraqet në nivel të lartë sistemin dhe arkitekturën operative, duke identifikuar entitetet e përfshira (palët e interesuara), rrjedhën dhe rolet kryesore të të dhënave.

Përveçkësaj, plan koncepti është rishikuar më tej në mënyrë që të përfshijë karakteristika shtesë (ose element të të dhënave) që duhet të jenë të dobishëm për Monitorimin dhe Vlerësimin e Sigurisë Rrugore.

Ne vazhdim të këtyre aktiviteteve, detyrat u përqëndruan në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderimit për implementimin e bazës së re të të dhënave dhe sistemit të informacionit për aksidentet rrugore. Këto dokumente (të përgatitur në tremujorin e mëparshëm) i referohen veçanërisht versioneve draft që do të rishikohen dhe përfundohen më pas.

Në mënyrë koherente me Plan Konceptin për përmirësimin e sistemit të përgatitur nën Detyrën 3.1.3, këto specifikime teknike dhe dokumentet e tenderit përshkruajnë veçoritë e sistemit të informacionit që do të zhvillohet dhe pajisjet që duhet të shoqërojnë sistemin.

Karakteristikat kryesore i referohen modulevetëndryshme që përbëjnë sistemin e informacionit, përkatësisht:

- Moduli për menaxhimin e të dhënave.
- Moduli për mbledhjen e të dhënave.
- Moduli i kërkimit.

- Raportimi i të dhënave (ose moduli i analizës të të dhënave).
- Modul GIS.
- Moduli i auditimit.
- Modul i bashkimit të të dhënave.

Është identifikuar çdopalë e interesuar e përfshirë në sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave të aksidenteve, duke marrë parasysh që jo të gjitha modulet dhe veçoritë mund të përdoren ngatërgjithëpalët e interesuara.

Në mënyrë të ngjashme, pajisjet janë përcaktuar bazuar në tiparet që duhet të përfshijë sistemi i informacionit dhe në numrin e përdoruesve të mundshëm.

Të gjitha këto rezultate janë përshkruar në Shtojcat e Raportit Fillestar (D.3.0) dhe të Raporteve të Përkohshme të Progresit n. 1 (D.3.1), n. 2 (D3.2), n. 3 (D3.3) dhe n. 4 (D3.4) të Komponentit 3.

Rezultatet e tjera për Aktivitetin 3.2 janë sintetizuar në kapitujt vijues dhe detajohen në Shtojcat e këtij raporti.

2. Progresi: Shkurt 2021 – Prill 2021

2.1 Hyrje

Aktiviteti 3.2 i Komponentit 3 “Trajnimi i stafit të agjensisë (MTI dhe ARRSH) në teknikat diagnostikuese dhe aplikimet e sistemit, dhe personelit policor si dhe personelit shëndetësor në kërkesat themelore të futjes së të dhënave”, synon rritjen e aftësive të palëve të interesuara shqiptare në procesin e mbledhjes së të dhënave të aksidenteve rrugore, në analizat e menaxhimit, bazuar në standardet ndërkombëtare.

Për të arritur objektivin e sipërpërmendur, janë hartuar aktivitetet e mëposhtme: Përgatitja dhe shpërndarja e programit të trajnimit në mbledhjen dhe analizën e të dhënave të aksidenteve në trafikun rrugor dhe mbi rëndësinë e aktiviteteve të sigurisë rrugore të bazuara në të dhënat (Detyrat 3.2.2 dhe Detyra 3.2.3)

Ky është raporti i pestë i progresit të ndërmjetëm i Komponentit 3 që mbulon Detyrat 3.2.2 dhe Detyrat 3.2.3.

2.2 Aktivitetet e realizuara

Plani i Punës i Komponentit 3 për tremujorin nga Shkurt 2021 deri në Prill 2021 është paraqitur në Figure 1.

Component 3 - Road Crash Data and Analysis System		feb-21	mar-21	apr-21
		Project Months		
3.2	Train agency staff in diagnostic techniques and system applications, and police staff as well as health staff in basic data entry requirements			
3.2.2	Implement the training program for the targeted areas			X
3.2.3	Monitor and Evaluate the training program			X

Figure 1 – Plan pune Shkurt 2021 – Prill 2021

2.2.1 [Mbështetje për përgatitjen e specifikimeve dhe prokurimin e një baze të re të dhënash /sistemi informacioni](#)

Aktivitetet gjatë këtij tremujori u përqendruan në përgatitjen dhe dhënien e një trajnimi mbi analizën e të dhënave të aksidenteve të trafikut rrugor.

Kjo detyrë është kryer duke ndjekur rezultatet e Komponentit 1 që kanë të bëjnë me zhvillimin e një kornize për mbledhjen, administrimin dhe analizën e të dhënave të aksidenteve Rrugore në Shqipëri.

Është përgatitur një raport që përshkruan aktivitetet kryesore të trajnimit të kryer, përfshirë materialin e përgatitur, metodologjitë e përdorura dhe format e vlerësimit dërguar pjesëmarrësve.

Të gjitha këto informacione janë të detajuara në Shtojcën 1 dhe 2 të këtij raporti.

3. Periudha pasardhëse

3.1 Plani i Punës

Aktivitetet që do të përfundojnë në tremujorin e ardhshëm kanë të bëjnë me Aktivitetin 3.3, që përfshin “Përgatitjen e një programi (kombëtar) pas projektit”. Ky aktivitet përfshin një Detyrë unike në lidhje me hartimin e programit Pas-projektit për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën e të dhënave të aksidenteve rrugore në Shqipëri (në mënyrë koherente me rezultatet e Aktiviteteve të mëparshme).

Figure 2 tregon planin e punës për periudhën pasardhëse

Component 3 - Road Crash Data and Analysis System		may-21	jun-21	jul-21
		Project Months		
3.3	Prepare a (national) post-project program for further system development			
3.3.1	Post-project program			X
F.0.1	Produce Final Overall Project Report			X

Figure 2 – Plani punës, periudha pasardhëse

3.2 Pasqyra e aktiviteteve

Aktiviteti 3.3

Detyra 3.3.1 do të përqendrohet në përgatitjen e një programi kombëtar pas-projektit për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të informacionit dhe mirëmbajtjen e tij. Do të konsistojë në përshkrimin e elementeve që do të përpunohen, mirëmbahen dhe azhurnohen më tej, pasi sistemi i informacionit të jetë funksional dhe pas përfundimit të projektit.